REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 87/17
Date/Datum. 05.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

A K T P Ë R C J E L L Ë S

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr. 87/17.**
Nga:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti për lëndën **"Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore Radiologjike-Ritender,** me nr. të Prokurimit: **701/16/113/211**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE- "Medical Group" sh.p.k – Prishtinë.**		
Datë			**05.04.2017**

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga **OE - "Medical Group" sh.p.k nga Prishtinë,** kundër AK – **"Qendra Klinike Universitare e Kosovës",** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore Radiologjike - Ritender,"** me nr. të Prokurimit: **701/16/113/211.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		29.03.2017		03.04.2017		05.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **27.03.2017**, OSHP, ka pranuar ankesën me nr.**87/17,** e parashtruar nga OE: **"Medical Group" sh.p.k,** nga Prishtina, kundër AK – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës", lidhur me aktivitetin të prokurimit: "**Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore radiologjike-Ritender"**-me nr. të Prokurimit:**701/16/113/211** .

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – "**Qendra Klinike Universitare e Kosovës".**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Medical Group" sh.p.k Prishtinë, dhe OE **NTP "Eurolab"** - Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **" Medical Group" sh.p.k-Prishtinë.** *Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Vendimi për anulimin e aktivitetit tenderues i marrë nga një organ politik dhe pa kompetencë në prokurimin publik pranë Autoritetit Kontraktues, dhe kjo në kundërshtim me Vendimin e Plotfuqishëm të OSHP-së PSH 450/16 dhe 451/16 dhe me shkaqet ligjore për të cilat lejohet anulimi i një aktiviteti tenderues pas dorëzimit dhe vlerësimit të ofertave.

Anulimi me pretendimin e tejkalimit të buxhetit është i pabazuar për shkak se ofertata e Operatorëve Ekonomik kanë qenë substancialisht më të lira sesa vlera e parashikuar e Kontratës dhe sa është ndarë dhe zotuar me Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve. Kjo paraqet shkelje serioze të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (Tutje i referuar si "LPP apo Ligji i Prokurimit). Ky vendim shkel nenet e mëposhtme të LPP-së

Vendimit përfundimtari OSHP-së PSH 450/16 dhe 451/16 i cili ka konstatuar se anulimi për mungesë të fondeve nuk është i bazuar dhe është i kundërligjshëm. Për më tepër, OSHPja me vendim përfundimtar e ka detyruar Autoritetin kontraktues të bëjë vlerësimin e ofertave.

Neni 8 Planifikimi i Prokurimit dhe Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur - Aktiviteti tenderues është planifikuar dhe përcaktimi i nevojave është bërë në përputhje të plotë me LPP-në. ZKA dhe ZKF-ja kanë përgaditur dhe nënshkruar "Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve", duke Zotuar mjetet. Vlera e parashikuar ka qenë EUR 600.000.00 (3 vite) dhe ofertat e Operatorëve kane qene nën këtë vlerë.

Neni 22, 23, dh24 Inicimi i Aktivitetit Prokurimit dhe Zyrtarët e Prokurimit-Vendimi për anulimin e

aktivitetit të prokurimit është marrë nga Bordi Drejtues i SHKSUK i cili është organ politik dhe pa asnjë kompetencë për aktivitetet tenderuese prane Autoritetit Kontraktues.

Neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike - Anulimi për mungesë fondesh është i paqëndrueshëm pasi Ofertata e operatorëve ekonomik të përgjegjshëm janë shumë më të lira se vlera e parashikuar e Kontratës me "Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" dhe Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës - Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 60 duke mos shpërblyer me Kontratë Operatorin Ekonomik me ofertën e përgjegjshme me cmim më të lirë.

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - Asnjë prej kushteve të parashikuara me Nenin 62 të LPP-së nuk janë plotësuar për të lejuar anulimin e këtij aktiviteti tenderues

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ky aktivitet tenderues është karakterizuar me shkelje serioze të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (Tutje i referuar si "LPP apo Ligji i Prokurimit), duke cënuar rëndë inegritetin e këtij procesi.

Për më tepër, Vendimi për Anulim i datës 13 Mars 2017 është marrë në kundërshtim me Vendimim e plotfusqishëm të OSHP-së.

Me datën 13 Mars 2017. Autoriteti Kontraktues Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka marrë Vendimin e dytë mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit për "Servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekesore radiologjike, me numër te prokurimit: 701-16-113211". Kjo me Arsyetimin e mungesës së mjeteve për realizimin e Kontratës.

Vendimi i datës 13 Mars 2017, paraqet bishtnim dhe ikje të zbatimit të të Vendimit përfundimtar të OSHP-së PSH 450/16 dhe 451/16 të datës 26 Janar 2016 i cili ka konstatuar se anulimi për mungesë të fondeve nuk është i bazuar dhe është i kundërligjshëm. Për më tepër, OSHP-ja me vendim përfundimta e ka detyruar Autoritetin kontraktues të bëjë vlerësimin e ofertave.

Me vendimin e OSHP-së PSH 450/16 dhe 451/16 është Anuluar Vendimi fillestar i Autoritetit Kontraktues për Anulimin e këtij aktiviteti tenderues dhe Autoriteti Kontraktues është detyruar të vazhdojë me vlerësimin e ofertave. Andaj, anulimi i dytë i aktivitetit tenderues nga Autoriteti Kontraktues me të njejtat arsye të cilat janë trajtuar me vendim të plotfuqishëm të OSHP-së paraqet një rast të vendosur res judicata, dhe Autoriteti Kontraktues në mënyrë të drejtëpërdrejtë është duke refuzuar zbatimin e Vendimit të plotfuqishëm të OSHP-së.

Fillimisht, i njejti Aktivitet tenderues është anuluar me Vendimin për Anulimin e Aktivitetit tenderues me datë 15 Nëntor 2016. Me vendimin e anulimit të parë të datës 15 Nëntor 2016 është theksuar se arsye për anulimin e Aktivitetit Tenderues është mungesa e fondeve. Kundër këtij Vendimi është paraqitur Ankesë në OSHP nga ana e Medical Group ShPK dhe Operatorët tjerë, e të cilat janë gjetur si të bazuara nga ana e OSHP-së.

Me vendimin e OSHP-së PSH 450/15 dhe 451/16. faqe 6, Paneli shqyrtues ka arritur në përfudim se:

... Bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues si dhe sqarimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, sqaron se qëndrojnë pretendimet e Operatorëve Ekonomik ankues, për shkak se nëse merre vlera e

parashikuar në Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve e që është EUR 600,000.00 (gjashtëqind mijë Euro), me përshkrimin e cmimeve tëprocesverbalin e hapjes rezulton se nuk është tejkaluar buxheti për të gjitha LOT sipas cmimeve të ofruara nga tenderuesi.

Rrjedhimisht, me provat e prezantuara është vërtetuar se arsyetimi për mungesë fondesh nuk qëndron. Kjo për shkak se fondet e tilla janë ndarë me Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë. Për më tepër, kjo është Kontratë 3 vjecare, dhe pagesat nuk lidhen me vetëm një vit fiskal. Anulimi i dytë me të njejtat arsye paraqet mos respektim të OSHP-së dhe ikje nga zbatimi i vendimit përfundimtar.

Për më tepër, në të Njejtin Vendim Paneli shqyrtues ka arritur në përfundim se Vendimi për anulim është në kundërshtim me Nenin 62 paragrafi 2 të LPP-së, për shkak se anulimi është bërë pas hapjes së ofertave. Neni 62 pika 2 specifikon se:

2.2 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Me Vendimin e datës 13 Mars 2017. Autoriteti Kontraktues është duke i përsëritur të njejtat shkelje dhe duke refuzuar të vazhdoj me vlerësimin e Ofertave sipas vendimit të OSHP-së PSH 450/16 dhe 451/16.

Vlera e parashikuar e Kontratës në Njoftimin për Kontratë dhe Dosie të tenderit, dhe se mjetet e Zotuara me Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve.

Në të njejtën kohë, pajisjet kryesore të Rentgenit dhe të Angeografisë (aparatura për vendosjen e stentave) janë pa mirëmbajtje dhe të njejtat nuk janë duke funksionuar. Këto shkelje serioze ligjore rrezikojnë seriozisht që prodhuesi i pajisjeve Shimadzu nga Japonia të tërëhiqet tërësisht nga tenderi dhe tregu i Kosovës duke rrezikuar në këtë mënyrë shëndetin publik. Në rast të tërheqjes prodhuesit Shimadzu, cmimi tenderit do të rritet substancialisht, dhe mirëmbajtja nga palët e treta nuk do mund të jetë profesionale sikurse nga vetë prodhuesi.

ANULIMI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT ËSHTË BËRË NË MËNYRË KUNDERLIGJORE

Në njoftimin për Anulimin e Aktivitetit Tenderues thuhet "Në mungesë të buxhetit (Pika: 4.2, Neni: 26, Ligji i PP) të anulohet aktiviteti i prokurimit për "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore radiologjike" me numër: 701-16-113-211.".

Ky pretendim është tërësisht i pabazuar për shkak se oferta e operatorëve ekonomik të Përgjegjshëm është shumë më e lirë se sa vlera e parashikuar e Kontratës. Në njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e tenderit, dhe më e rëndësishmja në Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve vlera e parashikuar e Kontratës është EUR 600,000.00. Këto kanë qenë edhe mjetet e

Provë. Njoftimi për Kontratë- Dosja etenderit - Procesverbali i hapjes së

Për më tepër, cmimi i këtij tenderi është shumë më i lirë se cmimet e pajisjeve tjera dhe të Servisimit dhe mirëmbajtjes së aparateve tjera brenda QKUK. Si shembull, pajisjet e SIEMENS servisohen dhe mirëmbahen me cmime shumë më të larta se sa ka qenë oferta e prodhuesit Shimadzu për pajisjet e veta ekuivalente.

VENDIMI

I. Aprovohet si e bazuar Ankesa e Operatorit Ankues Medical Group ShPK

II. Obligohet Autoriteti Kontraktues që të vazhdojë me procedurat e vlerësimit të ofertave dhe dhënie të Kontratës.

Demi Material Në rast të mos aplikimit të drejtë të dispozitave ligjore në lidhje me prokurimin publik dhe të respektimit strikt të kushteve të Dosjes së Tenderit, Medical Group ShPK do kërkojë të gjitha dëmet e drejtpërdrejta dhe fitimin e humbur.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	08.08.2016
Data e njoftimit te permiresimit te gabimint ne krpp	31.08.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbime/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,	09.09.2016
Afati i parapare per hapje te ofertave, pas zgjatjes,	09.09.2016
Data e njoftimit per anulim te AP	18.11.2016
Data e njoftimit per anulim te AP- hera – 2	14.03.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Një deklaratë me shkrim nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin n Aneksin 2
b. Deshmi nga ATK se OE ne fjale nuk eshte me vonese per pagimin e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit te vitit -Kërkohet nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën, para publikimit te njoftimit per dhenie te kontrates (nuk e eliminon tenderuesin gjate procesit te vlerësimit). (kopje)
c. Deshmi se OE ose ndonje drejtus i tij nuk eshte i denuar nga ndonje gjykate per veper penale ose gjate dy viteve te fundit eshte shpallur nga nje gjykate kompetente si i falimentuar ose likuiduar - Kërkohet nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën, para publikimit te njoftimit per dhenie te kontrates (nuk e eliminon tenderuesin gjate procesit te vlerësimit). (kopje)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi në regjistrin profesional, komercial dhe/apo të korporatave
2.Qertifikata e TVSH-se
3.Qertifikata e numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e certificates se biznesit
2. Kopja e Certifikates se TVSH-se

3. Kopja e Certifikates se numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar N/A

Dëshmia e kërkuar dokumentare: N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1.Autoriziminga Prodhuesi per servisim dhe mirembajtje ose nga Distributori i autorizuar

2.Qertifikatate serviserave

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Autorizimi nga Prodhuesi per servisimin dhe mirembajtjen e pajisjeve mjekesore radiologjike ose nga Distributori i autorizuar (**koronografi,Modeli: Angiospeed VC Prodhuesi Shimadzu Corporation kyoto japan; Angiography Sustem Shimadzu Modeli: Digital R/F Cvision Plus; Prodhuesi Shimadzu Corporation Kyoto Japan dhe Tomografi e kompjuterizuar Model SCT-7800 TC-Prodhuesi Shimadzu Corporation Kyoto Japan**)

2. Qertifikatate serviserave te autorizuar per mirembajtje dhe servisim te ketyre pajisjeve radiologjike.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Medical Group"	Prishtinë	Lot 1- **233,640,00 €** Lot 2 - 162,840,00 € Lot 3 - 53,100.00 € Lot 4 - **20.520.00** € Lot 5 - 49.680.00 € Lot 6 - 46.440.00 € Lot 7 - 25.920.00 €	JO
2.	"Eurolab"	Prishtinë	Lot 1 - 189.890.00 € Lot 2 - 166.760.00 € Lot 3 - 58.890.00 € Lot 4 - 18.920.00 € Lot 5 - **89.660.00** € Lot 6 - 47.965.00 € Lot 7 - **124.785.00 €**	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 09.09.2016, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesëdy (2) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Zenel Kuqi
- - Anëtar i komisionit - Antigone Kabashi
- - Anëtar i komisionit – Alberie Thaqi

Data e mbarimit të vlerësimit: 22.09.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....,//////////

Raporti i komisionit vlerësues:

Lot 1 –	Medical Group - Prishtine	-	233,640.00 €
Lot 2 –	Medical Group – Prishtine	-	162,840.00 €
Lot 3 –	Medical Group - Prishtine	-	53,100.00 €
Lot 4 –	Medical Group – Prishtine	-	20,520.00 €
Lot 5 –	Medical Group - Prishtine	-	49,680.00 €
Lot 6 –	Medical Group - Prishtine	-	46,440.00 €
Lot 7 –	Medical Group - Prishtine	-	25,920.00 €

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306)

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1. Autoriteti Kontraktues - "***Qendra Klinike Universitare e Kosoves***", gjatë këtijë aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim, kontratë publike **(kornizë - 36 muaj nga nënshkrimi i kontratës)** me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: ***"Medical Group" shpk,*** ka parashtruar përsëri ankesë kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit. Arsyetimi i njoftimit për anulim të këtijë aktiviteti të prokurimit i datës 14.03.2017 (njoftimi i 2-të), potencon: *"Në mungesë të buxhetit (Pika: 4.2, Neni: 26, Ligji i PP) të anulohet aktiviteti i prokurimit për "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore radiologjike" me numër: 701-16-113-211".*

Kundër të njejtit njoftimim konkretisht për lotet 1,2,3,4,5,6 dhe 7, të këtijë aktiviteti të prokurimit, parashtruesi i ankesës ***"Medical Group" shpk,*** më datën **16.03.2017**, paraqet kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimet ankimore se AK - QKUK, ka bërë shkelje të LPP-së, dhe atë nenit 8, 22, 23, 24, 26, 60 dhe 62, të LPP-së, si dhe vendimi të PSH-së, nr.450–451/16. Kundrejt të njejtës kërkesë AK- QKUK, më datën. 20.03.2017, nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim. Vendimi i njejtë nuk përmban arsyetim, e që si i tillë paraqet mos respektim të paragrafit 9, të nenit 108/A, të LPP-së në fuqi.

Sqarimi 2 Fillimisht sqarojmë se prashtruesi i ankeses , "Medical Group"shpk, ka risjellë të pretendimet të cilat janë trajtuar me rastin e shqyrtimit të ankesës së parë e që të njejtat janë vërtetuar edhe nga paneli shqyrtues sipas vendimit të datës 26 janar 2017, nr. 450-451/16.

Megjithatë me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, në vijim po ripërserisim sqarimin e dhënë në raportin paraprak, ku kemi shtjelluar - trajtuar pretendimet ankimore dhe atë si më poshtë:
"... në shkresa të lëndës së AK-së ekziston kopja e deklaratës e nevojave dhe përcaktimi disponueshmerisë së fondeve në vlerë prej 600,000.00 €. Të njejtën vlerë të parashikuar AK në pikën 2.4, të FDT-së e ka ndarë sipas loteve: Lot 1 – 200.000 €. Lot 2 – 170.000 €. Lot 3 – 60.000 €. Lot 4 – 20.000 €. Lot 5 – 60.000 €. Lot 6 – 50.000 €. Lot 7 – 40.000 €. Përshkrimi i çmimeve në procesverbalin e hapjës rezulton që nuk është tejkaluar buxhetin ***për të gjitha lotet*** *sipas çmimeve të ofruara nga tenderuesit. Poashtu procesverbali i hapjes se ofertave përman datën. 09.09.2016, ndërsa vlerësimi i ofertave për të gjitha lotet ka përfunduar më datën 22.09.2016..., anulimi i anktivitetit të prokurimit në këtë fazë bie ndesh me nenin* ***62.2*** *të LPP-së në fuqi...".*
Poashtu edhe paneli shqyrtues përmes vendimit të lartë përmendur, konkretisht përmes arsyetimit të të njejtit vendim, ka konstatuat se AK – QKUK, anulimin e aktivitetit të prokurimit e kishte bërë në

kundërshtim me nenin 9, dhe 62, të LPP-së, pasi që vlera e parashikuar në deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjejteve që është 600,000.00€, me përshkrimin e çmimeve në procesverbalin e hapjës rezulton që nuk është tejkaluar buxheti për të gjitha lotet sipas çmimeve të ofruara nga tenderuesit, rrjedhimisht i njejti vendim kishte aprovuar ankesën e OE "Medical Group"shpk, si të bazuar ndërsa lotet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, të këtijë aktiviteti të prokurimit, i kishte kthyer në **ri-vlerësim**. Megjithatë sipas shkresave të lëndës, nuk kemi hasur në ndonjë shkresë - raport të ri-vlerësimit të ofertave apo ndonjë njoftim - letër standarde me anë të cilës janë njoftuar ofertuesit me rezultatin e ri-vleresimit të ofertave. Andaj pretendimet ankimore i kualifikojmë si të bazuara pasi që AK – QKUK, nuk ka vepruar sipas rekomandimeve - konstatimeve të dala nga vendimi i PSH, nr. 450-451/16, dt. 26.01.2017.

Prandaj, në pajtim me sqarimet e mësipërme propozimi ynë për AK-në është që ti ndërmerr veprimet e nevojshme për ri-vlerësim të ofertave sipas rekomandimeve – konstatimeve të vendimit të panelit shqyrtues nr. 450-451/16, të datës 26.01.2017, gjithashtu t'i njoftoj ofertuesit mbi rezultatet e aktivitetit të prokurimit sipas LPP, në fuqi, dhe rregullave të prokurimit publik.

Mendimi i ekspertit:

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e potencuara në raport, i propozon panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit: **"Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore Radiologjike - Ritender,** me nr. të Prokurimit: **701/16/113/211, të kthehet në RIVLERESIM,** ndërsa ankesa e **OE - "Medical Group" sh.p.k – Prishtinë,** të aprovohet si **e bazuar.**